



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 241/114 Prot.

Tiranë, më 11.06.2024

UDHËZIM

Nr. 3, Datë 11.06.2024

PËR

**PROCEDURAT E PRANIMIT NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË  
“MJEKËSI URGJENCE” DHE “MJEKËSI FAMILJE”, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nenet 18, 70, 71, 77, 78 dhe 89, Vendimit nr. 2, datë 26.01.2024 “Për miratimin e kuotave të pranimit...”, Vendimit Qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024 “Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, si dhe Vendimit Qarkullues nr. 91, datë 11.06.2024 “Për një shtesë në vendimin qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024 “për miratimin e shpërndarjes së kuotave...” të Senatit Akademik të UMT-së, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, e përditësuar neni 41/1,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët aplikojnë në kuotat e paplotësuara në programet e specializimeve afatgjata në “Mjekësi Urgjence” dhe “Mjekësi Familje” për vitin akademik 2023-2024, në zbatim të Vendimit qarkullues nr. 91, datë 11.06.2024 “Për një shtesë në vendimin...” të Senatit Akademik të UMT-së, nga **data 18.06.2024 deri më datë 24.06.2024.**

Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe konkurrimit bëhen konform standardeve të cilësisë për programet e studimit të ciklit të tretë “Specializime Afatgjata”, si dhe Rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, e ndryshuar.

2. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të organizojë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e specializimeve afatgjata në “Mjekësi Urgjence” dhe “Mjekësi Familje”.
3. Kanë të drejtë të aplikojnë në kuotat e paplotësuara në programet e specializimeve afatgjata në “Mjekësi Urgjence” dhe “Mjekësi Familje”, kandidatët që:
  - a. Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë;
  - b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave” ose ekuivalente me të, dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë institucionit

përgjegjës, si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë.

4. Kandidati paraqitet personalisht ose një person tjetër i pajisur me prokurë përkatëse prej tij për të bërë aplikimin dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a. Formular aplikimi, sipas modelit të parashikuar në Shtojcën nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
  - b. Letër motivimi i/e aplikantit;
  - c. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë;
  - d. Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" si dhe të ciklit të dytë "Master i Shkencave", ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës / listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën /diplomat dhe listën / listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës. Në rast se njohja e diplomës nuk ka përfunduar ende, kandidati paraqet vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në institucionin përgjegjës dhe duhet të dorëzojë dokumentin e njohjes jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit;
  - e. Kopje e noterizuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit që vërteton njohjen e gjuhës së huaj, sipas përcaktimit në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, përkatësisht *"Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët e huaja: anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, sipas akteve nënligjore në fuqi, niveli B2"*.
  - f. Kopje e noterizuar e licencës së ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin profesional përkatës;
  - g. Dëshmi penaliteti e vlefshme;
  - h. Mandat pagesa për tarifën e aplikimit prej 5000 (pesëmijë) lekë;
  - i. Dy fotografi personale.
5. Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë brenda datës 24.06.2024 shpallin në faqen zyrtare web të fakultetit dhe/ose UMT- së listën emërore të kandidatëve që kanë aplikuar.
  - a) Kandidatët verifikojnë listën emërore të shpallur dhe në rast pasaktësish, bëjnë kërkesë për saktësim pranë dekanatit të fakultetit përkatës brenda datës 25.06.2024.
  - b) Dekanati pas kryerjes së verifikimeve shpallin brenda datës 25.06.2024 listat përfundimtare të kandidatëve.
6. Komisioni i Vlerësimit, bën vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve të cilët kanë aplikuar nëpërmjet shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, bazuar në notën mesatare të ponderuar të tyre, brenda 24 orëve.
7. Komisioni i Vlerësimit, shpall dhe afishon në vende të dukshme listën paraprake, brenda 24 orëve nga përfundimi i vlerësimit dhe renditjes, në mjediset dhe në faqen web të Fakultetit të Mjekësisë të UMT-së.
8. Kandidatët mund të ankimojnë rezultatin brenda 24 orëve nga shpallja e listës paraprake. Komisioni i vlerësimit merr në shqyrtim ankimimet dhe prononcohet brenda 24 orëve me vendimin përkatës.  
Pas këtij procesi, Komisioni i Vlerësimit shpall listën përfundimtare të kandidatëve të renditur sipas notës mesatare të ponderuar në rend zbritës.

9. Regjistrimi i kandidatëve të shpallur fitues në kuotat e paplotësuara në programet e specializimeve afatgjata në “Mjekësi Urgjence” dhe “Mjekësi Familje, bëhet brenda 3 ditëve nga shpallja e listës përfundimtare.
10. Brenda datës 08.07.2024 nga regjistrimi i kandidatëve fitues të fazës së I dhe II, UMT dërgon në QSHA, listën e studentëve specializantë të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi në zbatim të Udhëzimit Nr. 6, datë 19.02.2018 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” i ndryshuar të MAS.
11. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. QSHA pas verifikimit i kërkon UMT-së ta çregjistrojë atë.
12. Kuotat në programet e specializimeve afatgjata në “Mjekësi Urgjence” dhe “Mjekësi Familje janë të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe marrëdhëniet kontraktuale financiare lidhen mes specializantit dhe Ministrisë sipas parashikimeve në Rregulloren përkatëse.
13. Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen në këtë udhëzim merret për referencë Rregullorja e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, e ndryshuar.
14. Ngarkohet Fakulteti i Mjekësisë, UMT, për zbatimin e këtij Udhëzimi.
15. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSHA-së.



**Shtojca nr. 1**

**FORMULAR APLIKIMI PËR PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATË NË  
MJEKËSI FAMILJE DHE MJEKËSI URGJENCE**

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri

në \_\_\_\_\_, Vendbanimi \_\_\_\_\_

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Tel \_\_\_\_\_, Cel \_\_\_\_\_, E-mail \_\_\_\_\_,

**KËRKOJ:**

Të aplikoj për të vazhduar studimet në programin e ciklit të tretë Specializim Afatgjatë pranë Fakultetit të Mjekësisë, në Specializim Afatgjatë në:

- Mjekësi Familje;
- Mjekësi Urgjence,

duke përfituar nga:

- Kuotat e pranimit të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, nën përgjegjësinë time ligjore,

**DEKLAROJ se:**

Zotëroj:

- Diplomë të Integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në \_\_\_\_\_, lëshuar nga IAL \_\_\_\_\_, Shteti \_\_\_\_\_
  - të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
  - Diplomë të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në \_\_\_\_\_, lëshuar nga IAL \_\_\_\_\_, Shteti \_\_\_\_\_
  - të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
- Kam notë mesatare të ponderuar të gjithë viteve të studimeve universitare (cikli i parë+cikli i dytë ose diplomë e integruar e ciklit të dytë) \_\_\_\_\_ (me dy shifra të rrumbullakosura pas presjes dhjetore).
  - Nuk jam duke kryer dhe nuk kam kryer më parë një program specializimi afatgjatë në fushën e mjekësisë.
  - Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë:  Angleze, niveli \_\_\_\_\_

- Italiane, niveli \_\_\_\_\_
- Frënge, niveli \_\_\_\_\_
- Gjermane, niveli \_\_\_\_\_
- Spanjolle, niveli \_\_\_\_\_

- Bashkëlidhur këtij formulari kam dorëzuar:
  - Letër motivimi.
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.
  - Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” si dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës/listave të notave.
  - Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës.
  - Vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në organin kompetent (nëse procesi i njohjes nuk ka përfunduar ende). Dokumenti i njohjes duhet të dorëzohet jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
  - Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit/eve që vërteton/jnë njohjen e gjuhës së huaj/gjuhëve të huaja.
  - Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.
  - Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin Profesional përkatës në Republikën e Shqipërisë.
  - Dëshmi penaliteti e vlefshme.
  - Mandat pagesën për aplikimin dhe konkurrimin (e cila është e pakthyeshme)
  - Dy fotografi personale.
- Deklaroj se jam në dijeni të faktit se në përfundim të procesit të konkurrimit dhe pas regjistrimit, duhet të paraqes kontratën e nënshkruar me ministrinë përkatëse, jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e regjistrimit. Mosrespektimi i kësaj kontrate ka penalitetet përkatës të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve.
- Autorizoj UMT, Ministrinë përgjegjëse për arsimin, Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe QSHA për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve specializuese, si dhe publikimin eventual të tyre.
- Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t’u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
- Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

- Deklaroj se jam njohur me rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, e ndryshuar, si dhe kwtw udhëzim të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, udhëzimin, si dhe vendimin përkatës të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose QSHA nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve ligjore kompetente.

( \_\_\_\_\_ )

( \_\_\_\_\_ )

Emër Atësi Mbiemër  
i kandidatit

Emër Mbiemër  
i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit

Firma

Firma

Vendi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_\_

